



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 3.1, 3.3, 3.4 (i), (ii), 15.1 (e), 21.2 dhe 64 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr 28, data 4 qershor 2008), dhe Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 18/2012, e datës 3 Korrik 2012),

Me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores së AAC-së Nr. 5/2010, për zonat mbrojtëse të aeroportit, e datës 20 Tetor 2010,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 mbi procedurat për konsultim publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE NR. 4/2016
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 5/2010 MBI
ZONAT MBROJTËSE TË AEROPORTIT**

Neni 1

Titulli i Rregullorës Nr. 5/2010 duhet të ndryshohet si në vijim:
"Rregullorja Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aerodromit".

Neni 2

Në tërë tekstin e Rregullorës Nr. 5/2010 mbi Zonat Mbrojtëse të Aerodromit, shprehja "aeroport" duhet të zëvendësohet me "aerodrom", shprehja "Ligji Nr. 2004/15 mbi Ndërtimin" duhet të zëvendësohet me:"Ligji për Ndërtim", shprehja "Ministria dhe Komunat" duhet të zëvendësohet me "autoriteti kompetent".

Neni 3

Neni 1 duhet të zëvendësohet si në vijim:

“Kjo rregullore zbatohet për të gjitha subjektet juridike dhe personat fizik të cilët kanë në pronësi apo planifikojnë të ngrisin një apo më shumë ndërtesa në afërsi të një aerodromi, dhe për autoritetet kompetente të cilat sipas Ligjit për Ndërtim, janë përgjegjës për lëshimin e të gjitha lejeve të ndërtimit të listuara në të.”

Neni 4

Neni 2, duhet të ndryshohet si në vijim:

Përkufizimi për shprehjen “Aerodrom”, “Operator i aerodromit”, “Aneksi 14” dhe për “Standardin” duhet të zëvendësohen me këto në vijim:

Aerodrome - nënkupton një fushë të caktuar në tokë (përfshirë çfarëdo ndërtesë, instalime dhe pajisje) që mëtojnë të shfrytëzohen tërësisht apo pjesërisht për aterrim, nisje dhe lëvizje sipërfaqësore të avionëve. Në këtë rregullore, termi “Aerodrom” përfshinë heliportet.

Operator i aerodromit - nënkupton poseduesin e një Certificate të Aerodromit ose poseduesin e Aprovimit të Aerodromit.

Aneksi 14 - nënkupton Aneksin 14, Vëllimi I “Aerodromet” dhe Aneksin 14, Vëllimi II “Heliportet” të Konventës së Çikagos.

Standard - nënkupton çdo referencë në standarde të aerodromit siç janë të përfshira në Aneksin 14, në këtë Rregullore dhe në të gjitha standarde tjera të përcaktuara nga AAC-ja.

Sipërfaqet e kufizimit të pengesave (SKP) - nënkupton një seri sipërfaqesh që përcaktojnë volumin e hapësirës ajrore në dhe përreth aerodromit pa pengesa për të mundësuar operimet e sigurta të avionëve dhe për të parandaluar ndërtimin e objekteve në zonat përreth aerodromit, që do të ishin pengesë për funksionalitetin e aerodromit.

Përkufizimet e mëposhtme do të shtohen sipas radhitjes alfabetike:

Aerodromi i aprovuar - nënkupton një aerodrom, operatorit të së cilit i është dhënë aprovimi i aerodromit.

Heliport - nënkupton një aerodrom ose një zonë të përcaktuar në një strukturë të destinuar për t'u përdorur tërësisht ose pjesërisht për arritje, nisje dhe lëvizjet sipërfaqësore të helikopterëve.

Përkufizimi për “Aeroport” duhet të hiqet.

Neni 5

Neni 3, paragrafi 1 duhet të zëvendësohet me këto në vijim:

“Të gjitha aerodromet duhet të kenë Zona Mbrojtëse në të cilat aktivitetet e ndërtimit mund të kufizohen me qëllim të mos rrezikimit të operimeve të fluturimeve nga çdo pengesë.”

Neni 6

Neni 4, paragrafi 3 duhet të zëvendësohet me këto në vijim:

“Operatori i aerodromit duhet të vleresojë një aplikacion për leje ndërtimi, i cili hyn brenda kornizës së paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim:

- a) Sipërfaqet e kufizimit të pengesave;
- b) Efektet në pajisjet ndihmëse elektronike dhe vizuele për navigacion ajror;
- c) Mundësinë për tërheqje të pranisë së zogjve.”

Neni 4, paragrafi 4 duhet të zëvendësohet me këto në vijim:

“Operatori i aerodromit duhet brenda 15 ditëve pas pranimit të aplikacionit, të shqyrtoj dhe të jap vlerësimin final të arsyetuar substancialisht tek AAC, duke theksuar ndonjërin nga këto gjetje:

- a) pa vërejtje lidhur me ndonjë pikë të paragrafit 3;
- b) pa vërejtje, por me disa kushte të theksuara në mënyrë të duhur;
- c) me vërejtje, lidhur me ndonjë pikë të paragrafit 3.”

Neni 4, paragrafi 5 duhet të zëvendësohet me këto në vijim:

“Operatori i aerodromit mundet përjashtimisht dhe në bazë të ndërlkueshmërisë së çështjes, të kërkoj zgjatje të afatit të referuar në paragrafin 4.”

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 korrik 2016.

Prishtinë, 16 qershor 2016

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm